



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Radio Televizioni "Dukagjini" Sh.p.k.

Pronar - Ekrem LLUKA

Radio DUKAGJINI

Rr/Ismajl Qemajli, nr.2

Pejë

Ref:1609/968/KPM/am

V E N D I M

për ripërtëritjen e licencës së transmetimit të Radio Dukagjini, me seli në Pejë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuele, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe standardet ndërkombëtare.
2. Radio Dukagjini është subjekt transmetues me mbulueshmëri nacionale i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e radio programeve në territorin e Republikës së Kosovës, me seli në Pejë. KPM, me datën 28 gusht 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës afatgjatë për Radio Dukagjini.
3. Me datën 28 gusht 2016, afati i licencës së Radio Dukagjini ka skaduar, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga KPM brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 11 gusht 2016, Departamenti i Licencimit, pranë Zyrës Ekzekutive të KPM-së, e ka njoftuar të licencuarin lidhur me obligimet që parashihen me nenin 25, duke e udhëzuar kandidatin që të bëjë kërkesën për vazhdim të licencës, brenda afateve të përcaktuara me këtë nen, si dhe të kryej të gjitha obligimet ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së.


- Radio Dukagjini me datën 28 qershor 2016, ka parashtruar kërkesën me shkrim në KPM, për të shprehur interesimin e tij për ripërtëritje të licencës.
- Radio Dukagjini nuk ka obligime ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së.

Arsyetimi

- Radio Dukagjini ka vepruar pajtim me nenin 25 të Ligjit të KPM-së, duke parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së, e gjithashtu, ka kryer obligimet ndaj tarifës për licencë.
- Vendimi i KPM-së (**KPM V2-2016**), i datës 8 shtator 2016, krijon bazën ligjore që të ripërtërijë licencën e kandidati të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje.
- Duke marrë parasysh se Radio Dukagjini, ka vepruar në pajtim me udhëzimet e KPM-për të vepruar në pajtim me nenin 25 dhe nenin 26 të Ligjit për KPM-në, KPM konstaton se ka bazë të mjaftueshme për ripërtëritje të licencës së transmetimit për Radio Dukagjini.

V E N D I M

- Komisioni merr VENDIM për ripërtëritjen e licencës së Radio Dukagjini, për të ushtruar veprimtari në ofrimin e shërbimeve mediale audio, me interes publik në zonën ku operon.
- Licenca e transmetimit të KPM-së për Radio Dukagjini do të jetë e vlefshme në afat prej 7 (shtatë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 28 gusht 2016.
- Të gjitha parametrat e licencës së KPM-së, si: Kategoria e të Licencuarit, Skema Programore, Parametrat Teknik si dhe Harta e Zonës së Mbulimit, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
- Ky vendim hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të tij.



Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



19.09.2016

Data